

Konsultim me publikun
Linja e Transmetimit 400 kV Shqiperi - Maqedoni e Veriut (Fier - Elbasan - Qafe Thane)

Bazuar ne VKM nr. 686/2015 “Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit dhe deklarates mjedisore” dhe ne shkresen e Agjencise Kombetare te Mjedisit me lende “Njoftim per vazhdim procedure per VNM te Thelluar “Operatori Sistemit Transmetimit (OST)”, te dates 24.05.2021, per aplikimin me numer AN050520210006, per projektin “Linja e Transmetimit 400 kV Shqiperi - Maqedoni e Veriut (Fier - Elbasan - Qafe Thane)”, me zhvillues te projektit “Operatori i Sistemit te Transmetimit (OST)” dhe ndertues “Joint Venture Mitas Energy and Metal Construction Inc – Doko Sh.p.k.”, eshte hartuar raporti i Konsultimit me publikun, i cili eshte pjese e procedures se Raportit te Thelluar te VNM-se per projektin e cituar me siper.

Konsultim me publikun

Linja e Transmetimit 400 kV Shqiperi - Maqedoni e Veriut (Fier - Elbasan - Qafe Thane)



Projekt Zhvillimi i Republikes se Shqiperise permes Operatorit te Sistemit te Transmetimit Sh. a (OST) bashkefinancuar nga Republika Federale e Gjermanise permes KfW dhe nga Bashkimi Europian brenda Kornizes se Investimeve te Ballkanit Perendimor BMZ Nr. 2010 66 992

Përmbajtja

1. Hyrje

1.1. Përshkrimi i Projektit

1.2. Kuadri Ligjor dhe Administrativ

2. Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit

3. Përshkrimi për shkarkimet e mundshme në mjedis

4 Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis

5. Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë)

1. Hyrje

1.1. Përshkrimi i Projektit

Ky vlerësim i ndwrveprimit të projektit me mjedisin do të paraqesë një informacion të shkurtër të projektit që do të realizohet, ndikimet pozitive dhe negative në mjedis dhe masat që zhvilluesi do të ndwrvmarrë për zbatimin e kriterëve të nevojshme për mbrojtjen dhe menaxhimin sa më racional të mjedisit.

Theksojmë se shumë nga vlerësimet e detajuara të ndikimeve të mjedisit mbështeten në informacionet inxhinierike që duhet të merren parasysh. Vlerësimi identifikon në mënyrë të qartë si përfitimet pozitive edhe negative dhe përcakton "rezultate të përgjithshme" për secilën prej tyre. Vlerësimi identifikon se siprojkti i propozuar ndwrvepron me mjedisin dhe nëse ndikimet janë mesatare të pranueshme, të rëndësishme, të tërthorta apo të drejtpërdrejta.

Objekti i kësaj hyrje - përmbledhje për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe nwrveprimit të zhvillimit të projektit në studim:

- Të minimizojë streset në mjedis dhe në radhë të parë në elementet prioritarë si ruajtja e tokës, kontrolli i zhurmave, dhe ruajtja e cilësisë së ujit dhe ajrit
- Të ruajë ose rehabilitojë mjedisin natyror përmes elementeve të reja të ndërhyrjes pozitive, punimeve të veçanta në kuadër të projektit ose paralel me të, të cilët sigurojnë vijueshmërinë e qëndrueshme të mjedisit biologjik duke përfshirë faunën dhe florën në mjediset përreth zonës së marrë në konsideratë.

- LINJA E INTERKONJEKSIONIT 400 KV FIER-ELBASAN-QAFE THANE

Zhvilluesi i projektit: OPERATORI I SISTEMIT TE TRANSMETIMIT OST

Ndertues: Joint Venture Mitas Energy and Metal Construction Inc-DOKO

Modernizimi dhe zgjerimi i rrjetit të transmetimit në Shqipëri është një objektivi i vazhdueshëm. Në kontekstin e një Projekti Zhvillimi i Republikës së Shqipërisë përmes Operatorit të Sistemit të Transmetimit Sh. a (OST) bashkefinancuar nga Republika Federale e Gjermanisë përmes KfW dhe nga Bashkimi Europian brenda Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perendimor BMZ Nr. 2010 66 992, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sha) do të përdorë fondet e siguruar nga KfW për financimin e zbatimit të projektit: Linja e Transmetimit 400 kV Shqipëri - Maqedoni e Veriut (Fier - Elbasan - Qafe Thane).

Rritje të ndjeshme të ngarkesës vjetore të energjisë elektrike dhe disa burime të reja të gjenerimit të energjisë elektrike të shtuar në rrjetin e transmetimit shqiptar, kanë krijuar një ngarkesë shtesë në sistemet ekzistuese të transmetimit, duke çuar në ndërprerje të shpeshta të furnizimit me energji elektrike për konsumatorët vendas dhe industriale. Sistemet ekzistuese të transmetimit nuk do të ishin në gjendje të përballen me burimet e reja të gjenerimit të energjisë të planifikuara për zhvillim në Shqipëri dhe Jugut (p.sh. hidrocentralet në Devoll dhe impiantet e reja të energjisë elektrike me gaz apo nga energjia diellore). Për më tepër, për shkak të mbështetjes së saj në burimet e gjenerimit të energjisë hidrike (90% e se përgjithshme të energjisë mix), Shqipëria varet shumë nga reshjet vjetore dhe kështu potencialisht e prekshme nga ndikimet e ndryshimit të klimës.

Ky projekt është pjesë e nismës së Komisionit Europian për të krijuar një korridor të transmetimit të energjisë elektrike Lindje-Perendim midis Bullgarisë, Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë, Malit të Zi dhe Italisë. Korridori 8 është thelbësor në lejimin e shkëmbimit ndërkufitar të energjisë, përdorimin me efikas të

Konsultim me publikun
Linja e Transmetimit 400 kV Shqiperi - Maqedoni e Veriut (Fier - Elbasan - Qafe Thane)

kapaciteteve ekzistuese dhe te planifikuara te energjise, dhe balancimi me i mire i rrjedhes se ngarkeses ne rajon

Sipas projektit te pergjithshem, Loti 1 perfshin: Linjat ajrore, qe kane te bejne me ndertimin e nje 400 kV linja e transmetimit midis Fier - Elbasan - Qafe Thane (Kufiri Shqiperi / Maqedoni Veriore). Korridori i linjes per Fier - Seksioni i Elbasanit do te kete nje gjatesi te perafert prej 74 km dhe Seksioni Elbasan - Seksioni Qafe Thane do te kete nje gjatesi te perafert prej 56 km. Te dy seksionet do te konfigurohen si nje qark i vetem. Pas komisionimit te linjave te reja, Elbasani dhe Fieri do te jene pjese e rrjetit rajonal 400 kV, i ashtuquajture Korridori 8.

Jetegjatesia e ketij projekt do te jete per 50 vjet.

Projekti ka nje shtrirje hapesinore te gjere, duke perfshire linjat Fier – Elbasan dhe Elbasan – Qafe Thane. Koordinatat e Linjes se transmetimit ne sistemin Gauss Kruger paraqiten me poshte:

	Lista e koordinatave (Gauss Kruger 1986)			
	Linja Fier - Elbasan		Linja Elbasan – Qafe Thane	
Nr. i pikes	X (Easting) (m)	Y (Northing) (m)	X (Easting) (m)	Y (Northing) (m)
1	4377802.254	4507998.083	4422410.983	4549730.798
2	4377830.834	4507931.867	4422446.048	4549779.832
3	4377868.991	4507734.433	4422516.008	4549937.114
4	4378410.8	4507479.3	4423468.389	4550067.111
5	4378848.859	4507378.877	4424251.815	4550668.639
6	4382389.98	4504207.669	4425699.56	4550598.853
7	4386919.558	4503564.405	4427002.499	4551689.985
8	4387220.128	4503606.682	4426882.478	4552391.453
9	4389082.609	4506082.498	4426968.247	4552591.063
10	4390371.524	4506632.054	4427636.332	4552799.813
11	4391615.161	4506779.068	4428203.596	4553467.125
12	4393384.705	4508746.51	4428474.748	4553651.922
13	4395782.153	4509533.611	4428928.345	4554978.636
14	4396533.909	4512769.105	4429685.563	4555671.531
15	4397545.709	4513662.944	4431527.254	4556109.561
16	4399926.351	4518332.561	4434893.405	4557476.704

Konsultim me publikun
Linja e Transmetimit 400 kV Shqiperi - Maqedoni e Veriut (Fier - Elbasan - Qafe Thane)

Nr. i pikes	Lista e koordinatave (Gauss Kruger 1986)			
	Linja Fier - Elbasan		Linja Elbasan – Qafe Thane	
	X (Easting) (m)	Y (Northing) (m)	X (Easting) (m)	Y (Northing) (m)
17	4401868.01	4519403.314	4435497.632	4558028.82
18	4403715.701	4522069.897	4438431.193	4559541.552
19	4404697.851	4523011.643	4439530.691	4560742.645
20	4405317.426	4524583.313	4439624.842	4561140.759
21	4407432.436	4526975.6	4440674.244	4561574.865
22	4409383.793	4531378.252	4440986.964	4562247.235
23	4410202.269	4534243.013	4441820.219	4562573.445
24	4410905.426	4535156.4	4443300.496	4562429.573
25	4413593.531	4540423.885	4446896.477	4559172.157
26	4416297.009	4542598.119	4447783.37	4557935.755
27	4416485.865	4542628.435	4448899.79	4556691.652
28	4416551.819	4542748.641	4452169.462	4554267.009
29	4416788.231	4542888.646	4455356.776	4551683.743
30	4417084.494	4543111.934	4456381.9	4550829.626
31	4417477.123	4543515.69	4457106.671	4550575.584
32	4418405.001	4544615.641	4460335.772	4549255.823
33	4419518.991	4544845.825	4460853.491	4549723.079
34	4420730.671	4545334.254	4461475.979	4549928.945
35	4421884.723	4546349.056	4463963.716	4551397.668
36	4423563.428	4547478.212	4464900.162	4551244.295
37	4424370.137	4548515.355	4466141.255	4550589.616
38	4424128.89	4549513.042	4466653.685	4550751.949
39	4422484.893	4549745.591	4422484.893	4549745.591
40	4422440.008	4549692.533	4422440.008	4549692.533

Me poshte paraqiten ortofoto te linjes se plote, si dhe pjeseve te saj, harta topografike dhe foto nga perdorimi ekzistues:

Konsultim me publikun
Linja e Transmetimit 400 kV Shqiperi - Maqedoni e Veriut (Fier - Elbasan - Qafe Thane)



Fig. Ortofoto e linjes se plote (burimi: ASIG)

Konsultim me publikun

Linja e Transmetimit 400 kV Shqiperi - Maqedoni e Veriut (Fier - Elbasan - Qafe Thane)




Fig. Ortofoto e linjes Fier - Elbasan (burimi: ASIG)




Fig. Ortofoto e linjes Elbasan – Qafe Thane (burimi: ASIG)



Fig. Harta topografike e linjes se plote (burimi: ASIG)

1.2. Kuadri Ligjor dhe Administrativ

Procesi i hartimit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), ndihmon në përmirësimin e çdo lloj projekti në respektimin dhe mbrojtjen maksimale të mjedisit të zonës ku ai zbatohet.

Qëllimi i VNM-së është që të sigurojë që mjedisi në zonën ku zbatohet projekti do të konsiderohet i lidhur me gjithë çështjet e tjera të rëndësishme, në çdo etape të tij.

Ky raport është hartuar bazuar në legjislacionin mjedisor në fuqi dhe ka për qëllim të identifikojë, parashikojë dhe vlerësoj gjithë ndikimet e mundshme në mënyrë sistematike, të kuptueshme dhe objektive.

VNM-ja është vlerësimi mjedisor në një proces vlerësimesh (të mjedisit, planifikimit hapësinor, ndërtimit, etj.) që eventualisht mund të finalizohet me Lejen e Zhvillimit.

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis në fakt i përgjigjet në thelb këtyre pyetjeve kyç:

- A. Si do të ishte mjedisi pa projektin?** (për shembull Studimet Bazë). Kjo do të identifikojë dhe përshkruajë gjendjen aktuale të burimeve dhe karakteristikat ekzistuese në mjedisin që mund të ndikohet nga projekti dhe se si këto do të zhvillohen në mungesë të projektit.
- B. Çfarë do t'i ndodhë në mjedisit, si pasojë e projektit?** (për shembull Parashikimi). Kjo do të përshkruajë mjedisin siç është pa projektin dhe se si ai do të ndryshojë si pasojë e projektit në aspektin e burimeve mjedisore apo njerëzve (receptorët) që janë të ndikuar, natyrën dhe shkallën e ndryshimit, shtrirjen e tij gjeografike dhe kohorë.

C. A përbën kjo një shqetësim? (për shembull Vlerësimi) Parashikimi i ndikimit nuk është i mjaftueshëm.

D. Nëse është i rëndësishëm a mund të bëjmë ndonjë gjë në lidhje me të? (për shembull Zbutja). Së fundi, është e rëndësishme të kuptohet se, në qoftë se ndikimi është i rëndësishëm, mund të bëhet diçka për të shmangur, reduktuar, korrigjuar apo kompensuar për të. Zhvilluesi i projektit mund t'i përfshijë këto masa zbutëse në propozimet e projektit dhe autoriteti kompetent mund t'i përfshijë kërkesat përkatëse në kushtet e lejes së dhënë

Në mënyrë që autoritetet kompetente dhe palët e jashtme të interesuara të vendosin nëse projekti duhet të vazhdojë, është thelbësore që informacioni mjedisor i dhënë nga zhvilluesi në Raportin e VNM-së, t'i përgjigjet në mënyrë të qartë pyetjeve të mësipërme. Qëllimi i studimeve të VNM është që të gjeneroj dhe paraqesë këtë informacion në mënyrë të qartë, koherente dhe të saktë.

Ideja e VNM-së është të sigurojë informacion për vendim marrësit dhe publikun mbi pasojat mjedisore të zhvillimeve të reja të propozuara. Për më tepër ideja është që të promovohet zhvillimi që respekton mjedisin përmes identifikimit të masave të duhura forcuese dhe zbutëse.

Objektivi kryesor i VNM-së është të identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore të projekteve të reja të zhvillimit.

Brenda këtij qëllimi, procesi i VNM-së kërkon që:

- të konsiderohen alternativat për vendndodhjen dhe ndikimet mjedisore shoqëruese;
- të përmirësohet plani mjedisor i propozimit;
- të sigurohet që burimet janë përdorur si duhet dhe në mënyrë eficiente;
- të identifikohen masat e duhura për zbutjen e ndikimeve të mundshme të propozimit;
- të vendosen kushtet për ndërtimin; dhe
- të ndihmohet vendim marrja dhe informimi i publikut.

Procedura e VNM-së përfshin:

A. procesin paraprak të VNM-së;

B. procesin e thelluar të VNM-së.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) shqyrton kërkesat për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe në fund të secilës procedurë, paraprake apo të thelluar të VNM-së, merr Vendimin për VNM-në paraprake, ndërsa për VNM-në e thelluar përgatit Deklaratën Mjedisore me rekomandimet përkatëse dhe ia dërgon Ministrisë.

Në përfundim vendimmarrja konsiston në:

- Vendim - lëshuar nga AKM-ja në përfundim të procedurës paraprake të VNM-së
- Deklaratë Mjedisore - lëshuar nga Ministri në përfundim të procedurës së thelluar të VNM-së.

Vendimi

Vendimi i AKM-së në fund të procedurës Paraprake të VNM-së përcakton nëse një projekt i listuar në Shtojcën II të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, në fuqi, duhet apo jo t'i nënshtrohet procedurës së thelluar të VNM-së. Nëse AKM-ja vendos se projekti nuk duhet t'i nënshtrohet procedurës së thelluar të VNM-së, në vendimin e saj përcakton arsyet dhe konsideratat kryesore ku është mbështetur mendimi, mendimin e institucioneve të konsultuara, përshkrimin sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar dhe nëse është e mundur për të korrigjuar ndikimet negative të mundshme në mjedis.

Deklarata Mjedisore

Konsultim me publikun
Linja e Transmetimit 400 kV Shqiperi - Maqedoni e Veriut (Fier - Elbasan - Qafe Thane)

Rezultati përfundimtar i procedurës së thelluar të VNM-së, është Deklarata Mjedisore, e cila mund të përmbajë refuzimin ose miratimin me rekomandime për Autoritetin e Planifikimit për të vazhduar procesin në bazë të kushteve të specifikuar mjedisore.

Deklarata mjedisore shërben si dokument orientues për Autoritetin e Planifikimit dhe/ose çdo autoritet

Përgjegjës në procesin e vendimmarrjes, për një leje zhvillimi apo për një leje të caktuar për miratimin e një projekti të listuar në Shtojcat 1 dhe 2 të ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, në fuqi.

Dokument i bazë ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit mund të jetë:

- a. raport paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011, 'Për vlerësimin e ndikimit në mjedis' të ndryshuar;
- b. raport i thelluar i VNM-së për projektet e shtojcës I, të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011, 'Për vlerësimin e ndikimit në mjedis' të ndryshuar.

Baza ligjore

Tabela 1 – Baza ligjore e përdorur për qëllim të VNM-së

Ligji	Qëllimi
Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011, i ndryshuar	Për mbrojtjen e mjedisit
Ligji nr. 10440, datë, 07.07.2011, i ndryshuar	Për vlerësimin e ndikimit në mjedis
Ligji Nr. 128/2020, Për disa ndryshime dhe shtesa të Ligji nr. 10440, datë 07.07.2011, i ndryshuar	Për vlerësimin e ndikimit në mjedis
Ligji nr.10006, datë 23.10.2008, i ndryshuar	Për mbrojtjen e faunës së egër
Ligji nr. 81/2017	Për zonat e mbrojtura
Ligji nr.10 253, datë 11.3.2010	Për gjuetinë
Ligji Nr. 57/2020	Për Pyjet
Ligji nr. 68/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006	Për mbrojtjen e biodiversitetit
Ligji nr. 162/2014	Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis
Ligji nr. 10 463, datë 22.9. 2011, i ndryshuar	Për menaxhimin e integruar të mbetjeve
Ligji Nr.8450, datë 24.2.1999 i ndryshuar me: Ligjin Nr.9218, datë 08.04.2004, Ligjin Nr.9574, datë 03.07.2006 Ligjin Nr.9595, datë 27.07.2006 Ligjin Nr. 83/2013 Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 Ligjin Nr. 12/2013 Ligjin Nr. 71/2014	Për përpunim, Transportin dhe Tregtimin e Naftës, gazit dhe nënproduktet e tyre
VKM nr. 686, datë 29.07.2015, ndryshuar	Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e te afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis(VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore
VKM nr. 247, datë 30.04.2014	Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore
VKM nr. 575 date 24.06.2015	Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte
VKM nr.175, datë 19.1.2011	Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve
VKM nr. 371, datë 11.06.2014	Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin

Konsultim me publikun
Linja e Transmetimit 400 kV Shqiperi - Maqedoni e Veriut (Fier - Elbasan - Qafe Thane)

Ligji	Qëllimi
	e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorezimit të mbetjeve të rrezikshme
VKM nr. 418, datë 25.06.2014	Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim
VKM nr. 229, date 23. 04. 2014	Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme
VKM nr.519, datë 30.6.2010	Parqet Natyror Rajonal
VKM nr 352, datë 29.04.2015	Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës ne lidhje me te
VKM nr.897. datë 21.2.2011	Miratimi i Rregullave për Shpalljen e Zonave të Vecanta të Ruajtjes
VKM nr. 532, datë 05.10.2000	Për miratimin e studimit "Strategjia dhe Plani i veprimit për biodiversitetin
VKM nr. 676, datë 20.12.2002	Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare
VKM nr. 594, datë 10.09.2014	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për cilësinë e ajrit të mjedisit
Vendimi Nr. 435, datë 12.9.2002	Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë
Vendim Nr. 22, date 9.1.2008	Për caktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal
Vendim Nr. 1354, datë 10.10.2008	Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullosor
Vendim Nr. 396, datë 21.06.2006	Për kriteret e transferimit dhe të përdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore

Objekt i ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, është përcaktimi i kërkesave, përgjegjësi, rregullave dhe procedurave për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme negative mjedisore të projekteve të propozuara, private ose publike.

Sipas ligjit Për Mbrojtjen e Mjedisit, vlerësimi i ndikimit në mjedis i një projekti të propozuar zhvillimi është vlerësimi i ndikimeve të rëndësishme, të mundshme të asaj veprimtarie në mjedis.

Gjatë procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, kryhen identifikimi, përshkrimi dhe vlerësimi në mënyrën e duhur i ndikimit në mjedis të një veprimtarie, duke përcaktuar efektet e mundshme të drejtëpërdrejta dhe jo të drejtëpërdrejta mbi tokën, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale, trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre të ndërsjella.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis zbaton parimin e parandalimit që në fazën e hershme të planifikimit të projektit, me qëllim shmangien apo minimizimin e efekteve negative në mjedis, përmes harmonizimit dhe përshtatjes së saj me kapacitetin bartës të mjedisit.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërkimit të lejeve përkatëse të zhvillimit.

Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij, të përafuara plotësisht me Direktivën e bashkimit Evropian për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis ka për qëllim të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis,

Konsultim me publikun

Linja e Transmetimit 400 kV Shqiperi - Maqedoni e Veriut (Fier - Elbasan - Qafe Thane)

nga projekte të propozuara para miratimit të tyre për zhvillim dhe garantimin e një procesi të hapur vendimmarrje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis, në mënyrën dhe kohën e duhur si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të.

Ky ligj zbatohet për projektet e propozuara, private apo publike, të cilat mund të shkaktojnë ndikime të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, si pasojë e madhësisë, natyrës apo vendndodhjes së tyre.

Kërkesa të përgjithshme për vlerësimin e ndikimit në mjedis të një projekti:

- Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit apo mos zbatimit të projektit.
- Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur në kohën e paraqitjes së raportit përkatës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit.
- Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përgatitjen, zbatimin, funksionimin dhe mbylljen e tij, sipas rastit, edhe pasojat e mbylljes së veprimtarisë, dhe dekontaminimin/pastrimin apo rikthimin e zonës në gjendjen e mëparshme, nëse një detyrim i tillë parashikohet me ligj. Vlerësimi përfshin, sipas rastit, si funksionimin normal, ashtu edhe mundësinë për aksidente.
- Vlerësimi i projektit përfshin, gjithashtu, propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara.

Aspektet më të rëndësishme të procesit paraprak të VNM-së, janë konsultimet me palët e tjera dhe vendimi nëse kërkohet një VNM e thelluar.

VNM paraprak është faza e parë e procesit të VNM-së. Sipas Nenit 8 të ligjit të VNM qëllimi i VNM Paraprak është të identifikojë propozimet që kërkojnë VNM të thelluar. VNM Paraprak përjashton nga procesi ato propozime (shumicën) që nuk kanë ndikime të rëndësishme, ose pak, ndikime lehtësisht të kontrollueshme, dhe për të cilat VNM është e panevojshme. Në vijim, Tabelat dhe Listat e Kontrollit do të ndihmojnë në procesin i cili vendos nëse kërkohet VNM për një projekt të veçantë ose tip projekti.

Tre fazat kryesore e VNM Paraprak janë:

- **Paraqitja e kërkesës** dhe dokumentacionit shoqëruar nga zhvilluesi në Ministrinë e Mjedisit, kontrolli administrativ paraprak i aplikimit nga Ministria e Mjedisit dhe përcjellja e tyre nga Ministria në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM);
- **Kontrolli teknik paraprak** i bërë nga AKM dhe konsultimi i AKM me institucionet e tjera dhe publikimi i aplikimit;
- **AKM njofton për vendimin e marre**, nëse projekti është apo jo e nevojshme t'i nënshtrohet procedurës së thelluar të VNM, Ministrinë e Mjedisit (MM) dhe palët e përfshira në proces, dhe publikon vendimin në faqen e internetit të AKM.

Konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare në lidhje me procesin e VNM-së

Direktiva e Këshillit të BE-së 97/11/EC e cila modifikoi Direktivën 85/337/EEC mbi Vlerësimin e Disa Projekteve Publike e Private, parashikon që autoritetet kompetente të shteteve anëtare të kërkojnë kryerjen e një vlerësimi të ndikimit mjedisor (VNM) për projektet që mund të rezultojnë me ndikim domethënës në mjedis. VNM duhet të përgatitet para miratimit të projektit, në mënyrë që vendimi për miratim të marrë parasysh ndikimet e mundshme të projektit në mjedis. Direktiva paraqet një listë të projekteve që kërkojnë studimin e VNM në të tëra rastet (Shtojca 1) dhe një listë të projekteve që mund të kërkojnë një studim të përmblendhur VNM (Shtojca 2), në varësi të një vlerësimi për ndikimet e mundshme që mund të rezultojnë nga projekti i propozuar apo të kriterëve kufizues, të vendosura nga secili shtet anëtar.

Konsultim me publikun

Linja e Transmetimit 400 kV Shqiperi - Maqedoni e Veriut (Fier - Elbasan - Qafe Thane)

Direktiva kërkon që “VNM të identifikojë, përshkruajë e vlerësojë në mënyrën e duhur ndikimet e drejtpërdrejta e indirekte të një projekti për:

- Qeniet njerëzore, florën dhe faunën;
- Tokën, ujin, klimën dhe peizazhin;
- Asetet materiale të trashëgimia kulturore; dhe
- Ndërveprimin midis faktorëve të lartpërmendur.

Informacioni tjetër që përcaktohet në direktivë që duhet të përfshihen në studimin e VNM-së jepet në Shtojcën IV të Direktivës 97/11/EC dhe ajo përfshin:

- një përshkrim të projektit;
- një përvijim të alternativave kryesore të vendodhjes dhe të teknologjisë të marra në shqyrtim për projektin e propozuar;
- një përshkrim të aspekteve të mjedisit që mund të ndikohen me shumë nga projekti e që lidhen me popullsinë, florën, faunën, tokën, ujin, faktorët klimatik, asetet materiale, pejsazhin e raportin reciprok mes faktorëve të lartpërmendur;
- një përshkrim të ndikimeve domethënëse të projektit që dalin në pah nga ekzistenca e vetë projektit, shfrytëzimi i burimeve natyrore, çlirimi/shkarkimi i lendeve ndotëse, krijimi i zhurmave dhe trajtimi i mbetjeve;
- një përshkrim i masave të parashikuara për parandalimin, uljen dhe aty ku është e mundur, mënjanimin e efekteve të dëmshme në mjedis; dhe
- një përmbledhje jo-teknike e informacionit të siguruar.

Direktiva 97/11/EC (amenduar nga Direktiva 2003/35/EC pas nënshkrimit të Konventës së Aarhus nga Komuniteti, më 25 Qershor 1998, mbi pjesëmarrjen e publikut në vendim-marrje dhe akses në vendosjen e drejtësisë në çështjet mjedisore) gjithashtu parashikon konsultimin me publikun, në fazën e propozimit e mbledhjes së informacionit, për t'i dhënë publikut të interesuar mundësinë për të shprehur mendimin e tyre para marrjes së vendimit lidhur me zhvillimin e propozuar.

Shqipëria është anëtare dhe ndjek detyrimet e konventave të mëposhtme ndërkombëtare:

Tabela 2 –Konventat ndërkombëtare në lidhje me procesin e VNM-së

Ligji	Qëllimi
Konventa e Bernit (CH), miratuar me anë të ligjit nr 8690, më 2 Mars 1998	Për mbrojtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisin e saj natyror në Evropë
Konventa e Barcelonës dhe protokollet e saj	Për mbrojtjen e mjedisit detar dhe ujor të Mesdheut
Konventa e Bonit	Mbi mbrojtjen e faunës së egër shtegtarë
Konventa e Vienës, miratuar me anë të ligjit nr. 8216, më 13 Prill 1997	Mbi kontrollin e kalimit kufitar të mbetjeve të rrëzikshme dhe asgjësimin e tyre
Konventa e Vienës dhe Protokollin e Montrealit	Për mbrojtjen e shtresës së Ozonit dhe mbi substancat që dëmtojnë shtresën e Ozonit
Konventa e Aarhusit, miratuar me ligjin nr. 8672, më 26 Tetor 2000	Mbi të drejtën e publikut për t'u informuar, për pjesëmarrje në vendim-marrje dhe e drejta për t'iu drejtuar organeve të drejtësisë për çështjet mjedisore
Konventa hyr në fuqi në 4 Tetor 1991	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis në kuadrin Ndërkombëtar
Konventa e Kombeve të Bashkuara, Tetor 1994	Ndryshimet Klimatike
Konventa e Kombeve të Bashkuara, Janar 1994	Biodiversitetin
Konventa e Kombeve të Bashkuara, Prill 2000	Konventa kundër zgjerimit të shkretëtirave në vendet e thata, vecanërisht në Afrikë

2. Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit

Ndikimet negative në mjedis:

Para se të kalojmë tek vlerësimi dhe identifikimi i ndikimeve në mjedis, ne shoqëri dhe ekonomi është e domosdoshme të njohim natyrën e ndikimit/eve. Ndikimet mjedisore, sociale e ekonomike të një projekti janë këto ndryshime rezultante në parametrat mjedisore, sociale e ekonomike, në hapësirë dhe kohë, karahasuar me çfarë mund të ketë patur ndodhur kur projekti nuk do të ishte marrë. Parametrat janë të çdo tipi të receptorëve mjedisore, sociale e ekonomike, shënuar mëparë: si cilësia e ajrit, cilësia e ujit, zhurmat, vibrimet, papunësia, etj. Ndikimet në mjedis në përgjithësi trajtohen si ndikime:

1. Gjate fazes ndertimit
2. Gjate fazes se funksionimit

Në shumicën e rasteve gjenerimi i një vlerësimi të ndikimit në mjedis mundëson raportimin mbi rëndësinë e një ndikimeve të caktuara sipas një shkalle vlerësuese : Është e rëndësishme të theksohet se kategoritë treguese janë të nevojshme si për efektet pozitive (të dobishme), ashtu dhe ato negative (negative). Pesë kategoritë treguese mundësojnë gjetjen e tërë rezultateve të mundshme. Duke aplikuar formulën, ndjeshmërinë më e madhe e mjedisit apo vlerën e receptorit ose të burimit, si dhe madhësinë e ndikimit, më i saktë do të përcaktohet efekti. Pasojat e një ndikimi negative në burim do të ketë një efekt shumë të rëndësishëm negativ. Tendencia për zbutjen e ndikimeve të negative mundshme mjedisore është për ti shmangur ato kudo që të jetë e mundur. Kjo do të arrihet duke marrë parasysh mënyrat për të parandaluar efektet negative në burim, para se të mendohet për marrjen e masave zbutëse të mëvonshme. Kjo është arritur përmes përzgjedhjes

2.1 Ndikimet negative në karakteristikat fizike të zonës së projektit;

Ndikime ne Ajer

Gjate fazes se ndertimit te objektit, procesi i punes do perfshije dhe germimet te cilat mund te sjellin emetim pluhurash ne atmosfere. Shoqeria investitore do te zbatoje masat e percaktuara ne raportin e VNM-se ne menyre qe emetimi i pluhurit ne atmosfere te jete sa me i vogel. Ky ndikim do te shfaqet vetem gjate fazes se ndertimit te objektit, gjate ndertimit te shtyllave. Gazet e demshme te cliruara nga djegia e karburantit te automjeteve mund te krijohen gjate fazes se ndertimit te objektit por gjithnje pa i kaluar limitet e lejuara, nderkohe qe gjate shfrytezimit te objektit emetimet e gazeve te demshme do te jene vete nga qarkullimi

i automjeteve. Çlirimet e gazrave në ajër që lidhen me ndertimin e objektit mund të ndodhin nga dy burime te pavarura:

- Çlirime ndotesish nga djegiet e makinave private dhe atyre të ndertimit, me motor me djegie te brendshme.
- Pluhuri qe del nga punimet e germimeve te hapjes se themeleve te shtyllave

Çlirimet e gazrave në ajër që lidhen me ndertimin, për dy tipet e burimeve që u përmendën ndryshojnë sipas llojeve të veprimtarive dhe lidhen me fazat e ndryshme tipike të një projekti ndertimi. Kështu mund të dallohen fazat e mëposhtme të këtyre çlirimeve në projekt e vepres:

- Përgatitja e zonës për ndërtim që përfshin nivelimin dhe stabilizimin e dheut, aktivitetet prerese dhe mbushese, të cilat mund të përfshijnë levizjen me makineri të renda për zhvendosjen e dheut apo masave të shtrëguara, ngarkimin e materialeve,
- Largimi i mbeturinave të pengesave natyrore dhe atyre të krijuara nga dora e njeriut, të cilat mund të përfshijnë hedhjet në erë, shperthimet, heqjet mekanike, ngarkim/shkarkimet e materialeve.
- Ndertimi i përgjithshëm; i themeleve, punimeve të brendshme dhe të jashtme, instalimeve elektrike. Çlirimet e gazrave dhe pluhurave në ajër nga këto veprimtari të zakonshme ndertimi përfshijnë:
- Çlirimet e gazta nga djegiet (COV, NOx, CO, SOx, PM10) nga makineritë e renda levizese me dizel apo benzine, pajisjet ndihmese portative si dhe automjetet e transportit të punonjesve
- Pluhurat që dalin (PM10) nga germimi i dheut apo nga shëmbjet e ndryshme që ndodhin në kantier

Ndikimi në perberjen e flores dhe faunes

Nga zbatimi i projektit ndikimet në flore do të jenë minimale. Gjate kryerjes së punimeve për ndertimin e linjes elektrike do të ketë prirje degesh të pemeve që pengojnë shtrirjen e kabujve elektrik dhe do të ketë ndikim në bimesi në pjesën ku do të ndërtohen shtyllat e linjes elektrike. Të gjitha ndikimet në bimesi do të zbuten nga masat e marra për rehabilitimin dhe sistemimin e mjedisit. Demtimet në flore do të jenë minimale në krahasim me përfitimet që do të sjell zbatimi i projektit.

Zbatimi i projektit dhe zhvillimi i tij nuk ndikojnë negativisht në humbjen dhe demtimin e habitateve si dhe të specieve shtazore. Mund të ketë ndikim në faunën nëntokesore (insekte etj) gjate fazes së ndertimit të shtyllave elektrike por jo ndikime të konsiderueshme për një projekt me një rëndësi të tillë. Ndikimet gjate shfrytëzimit do të jenë vetëm për shpendet. Karakteristikat e linjës së energjisë mund të ndikojnë gjithashtu në rrezikun e përplasjes së shpendëve bazuar në tensionet të ndryshme të linjës së energjisë dhe kështu konfigurimit, veçanërisht duke përfshirë numrin e niveleve vertikale, lartësinë e telit dhe praninë e telit mburojë. Shumë specie në kategoritë më të larta të rrezikut të mbijetesës kërcënohen prandaj ulja e niveleve të përplasjes me linjat elektrike mund të luajë një rol të rëndësishëm në popullsinë e tyre. Humbja e disa apo edhe e një individi mund të ndikojë në qendrueshmërinë e një popullatë lokale ose edhe në qendrueshmërinë e popullatës së përgjithshme.

Ndikimi në erosion

Degradimi fizik dhe erozioni i tokës mund të jenë problem për shkak të terrenit. Siç është e shpjeguar edhe në studimin gjeologjik toka ku do të ndërtohet vepra është e qendrueshme dhe janë bërë llogaritjet e nevojshme që objektet dhe terreni ku ato do të ndërtohen të jenë po ashtu të qendrueshme. Në zonën që analizohet, projekti i propozuar do të ketë impakt pozitiv. Nderhyrjet për ndertimin e shtyllave do të sistemojnë terrenin për shmangien e erozionit (sepse do të jenë edhe në favor të projektit). Nuk do të ketë erozion të tokës dhe do të bëhet sistemi i kullimit të ujërave në periudhë reshesh.

Ndikimi në toke

Gjate fazes së ndertimit Nga studimi gjeologjik është konstatuar që zona përbehet nga formacione të qendrueshme. Ndikimi i punimeve për ndertimin e objektit dhe permasat e ndërhyrjeve do të jenë konsiderueshme, por megjithatë këto inerte që do të dalin gjate punimeve do të sistemojnë dhe do të dergojnë në venddepozitim dhe miratuar nga Pushteti Vendor. Mund të ketë derdhje aksidentale të

karburanteve te automjeteve gjate ndertimit te objektit, por me ndikim te perkohshem. Toka eshte element qe peson ndryshime gjate zbatimit te projektit (gjate ndertimit te objektit sepse:

- Do te germohe material per ndertimin e shtyllave
- Do te kryhen punime betoni (M 150, M200 dhe M250).
- Keto punime, te cilesuara me lart shoqerohen me nje volum te vogel germimesh.
- Do te shtrohet zhavorr dhe do te behen punime te ndryshme si, betonime, dhe risistemime per riformulimin e peisazhit duke e kthyer ate ne gjendjen e meparshme visuelle etj. Ndertimi i ketij objekti fillimisht do te kerkoje ngritjen e kantjerit te punimeve sipas percaktimit te vendit qe do te vendoset ne bashkepunim te sipermarresit te punimeve dhe njesise se qeverisjes vendore ne njoftim dhe dijeni te supervisorit te punimeve dhe me pas do te behen germimet e percaktuara ne projekt – preventivin e hartuar per kete lloj objekti me ane te mjeteve germues dhe largimi i materialit do të bëhet nga mjete vetshkarkuese apo kamionë të një tonazhi të caktuar.

Tek punimet e germimeve duhet nga njëra anë të mbrohen njerëzit, të cilët nuk janë të përfshirë në ndërtimin e projektit, e nga ana tjetër duhet të mbrohen njerëzit e inkuadruar në realizimin e projektit. Gjithashtu duhet mbrojtur kantjeri i punes ne menyre te panderprere gjate te gjithë kohes.

Cikli i germimit do te perfshije:

- Germimet e siperfaqeve te demtuara te asfaltuara te trupit te rruges qe do te rigjenerohen.
- Germimet per hapjen e segmenteve te reja te ketij aksi sipas parashikimeve dhe projektit ne menyre qe te arrihen standartet e kesaj kategorie rruge.
- Germimet ne thellesite e percaktuar per hapjen e kanaleve te reja ne segmentet e reja te cilat do te behet konform projektit duke zbatuar te gjitha kushtet teknike te projektimit dhe zbatimit.
- Ngarkimin e

nëpër kamionë apo largimin e këtij materiali dhe depozitimin e tij në vendet e autorizuara nga njesia vendore.

- Kthimin e automjeteve të transportit per ne zonen e ndertimit te projektit. Mbrojtja e njerëzve të paaautorizuar duhet bërë në atë mënyrë që të bëhet rrethimi (me gardh, rrjetë gabiant etj.) I vendeve qe do punohet ne lartesi ose thellesi i cili nuk i lejon ata (sidomos fëmijët) të rrezikohen. Gjithashtu, duhet vendosur tabela paralajmëruese me të cilën ndalohe kalimi i rrethimit nga persona te paaautorizuar.

Ndikimi ne regjimin dhe perdorimin e ujerave te zonave ku do te zhvillohet projekti

Shumë nga ndikime të mundshme në mjedis mund të kufizohen përmes projektimit duke ndjekur metoda të mira të ndërtimit në praktikë. Të gjitha punimet do të kryhen në përputhje me standartet e ngjashme të miratuara. Aty ku është e praktikueshme, projektimi i të gjitha strukturave te projektit do te jete në përputhje me legjislacionin ne fuqi. *Zbatimi i projektit nuk do te ndikojne ne regjimin dhe ne perdorimin e ujerave.* Gjate fazes se shfrytezimit nuk do te kete ndikime *ne regjimin dhe ne perdorimin e ujerave.*

Ndikimet e mundshme nga shkarkimet në ujërat nëntoksore

Projekti ne studim ka nje perfshirje te gjere ku perfshin disa lloje ujrash nentokesore dhe siperfaqesor. Ndikimet negative ne ujrata nentokesore mund të vijne nga derdhjet e naftës dhe të ujërave të zeza të krijuara gjatë punimeve të ndërtimit. Ndikimet e nga shkarkimet e mundshme mbi ujërat nëntokësore:

- Ndikimet e mundshme mbi ujërat nëntokësore nga punimet e ndërtimit, themelet dhe vepra të tjera të lidhura tokën;
- Makineri në ndërtim dhe kamionet transportues të cilat mund të sjellin rrezikun e ndotjes nga karburanti dhe vaji.

Gjate fazes se operimit, ndikimet e mundshme janë të vogla me probabilitet të ulët dhe në masë lokale nga ndotja nga derdhjet e naftës ose nga burime te tjera.

Ndikimet e mundshme nga shkarkimet mbi ujërat sipërfaqësore

Ndikimet e mundshme mbi rrjedhat e ujit të lidhura me parandërtimore dhe veprimtaritë e ndërtimit të ndryshme (ndërtimi i rrugëve hyrëse eventual, punime tokësore dhe kullimit; makinerive të ndërtimit dhe mjeteve të transportit; kullat fondacionet ndërtimet, etj), përfshijnë:

- Rritja e pezullive në ujërat të nga germime e dherave;
- Rreziku i mundshëm i ndotjes nga lëndë djegëse si nafta, mbetjet e ngurta, etj .;
- Rreziku i ndikimit negativ në objektet e furnizimit me ujë;
- Erozioni dhe sedimentimi;

Ndikimet e mundshme negative në ujërat sipërfaqësore janë vlerësuar të ulët, të një probabiliteti të moderuar dhe me shtrirje vetëm lokale. Ndikimi në mjedis gjatë operimit dhe mirëmbajtjes. Nuk ka asnjë ndikim parashikuar mbetur në ujërat sipërfaqësore, gjatë fazës së operimit.

Ndikimi ne zhurma dhe vibrimet

Gjate fazes se ndertimit zhurmat dhe vibrimet jane nje ndikim i pashmangshem ne mjedisin ku do te kryhet nderhyrja. Zhurma mund te vijne nga perdorimi i makinerive ne ambientin e punes. Ne rastin tone zhurmat do te jene si pasoje e mjeteve te renda, gjate fazes se ndertimit, gjate germimit, transportit (ngarkim shkarkim). Keto zhurma do te jene te perkohshme dhe nuk do te kete akumulim te saj tek njeriu. Punonjesit do te jene me te prekshmit nga keto zhurma, per te cilet do te kerkohet zbatimi i masave te sigurimit teknik ne pune. Te shkaktuara gjate kalimit te mjeteve te ndertimit te tonazhit te larte: Do te ndihen vibrime ne mjedisin aty prane. Do te shkatohen vibrime dhe nga vibriatori i llacit qe do te perdoret per te realizuar shperndarjen e llacit mire neper themelet e shtyllave elektrike. Gjate ndertimit do te ndikohet vetem ne jeten e punonjesve te ndertimit dhe si dhe ne mjedis e banuar aty prane sheshit te ndertimit, por ndikimi do te jete ne nivele te ulta pasi siperfaqja e ku do te kryhen punime do te jete e vogel dhe e shperndare. Zhurma e krijuar nuk do te jete e ndryshme nga zhurma e pergjithshme e krijuar nga punimet e ndertimeve civile. Zhurma pritet te jete e moderuar por e perkohshme pasi kontraktuesit aplikojne teknologjine me te fundit per kontrollin e uljeve te vibrimeve dhe zhurmave ne menyre te konsiderueshme pa rritje te shpenzimeve operative. Niveli i zhurmave i parashikuar gjate kesaj faze eshte e i pranueshem dhe konform normave ne fuqi. Te gjitha pajisjet qe leshojne zhurme do te mirembahen ashtu siç duhet per te minimizuar ndikimin e zhurmës ne zone. Pajisjet qe leshojne zhurme duhet te plotesojne standartet e BE rreth zhurmës te shkaktuar ne mjedis.

Ndikimi ne mjedisin human

Realizimi i projektit nuk do te kete ndikime ne levizjen apo zhvendosjen e popullates se zones. Nga raporti i objektit si planvendosje me komunitetin ben qe vepra te mos influencoje negativisht ne demografine komunitare. Gjate ndertimit te objektit nje pjese e popullsise do te punesohen duke ndikuar ne rritjen e te ardhurave te tyre. Duke qene se nje pjese e projektit eshte ne afersi me zonat e banuara do te merren masa per mos prishjen e qetesise se banoreve nga zhurma gjate punimeve per rikonstrukcionin e objektit. Situata pak shqetesuese per banoret qe jetojne ne afersi te zones se projektit eshte krijimi i problemeve ne qarkullim duke qene se do te rritet numri i makinerive te medha ne ate zone, qe tranportojne materiale te nderimit. I vetmi ndikim ne shendetin e njerezve eshte ai i situatave qe mund te shkaktohen gjate zbatimit te objektit. Zbatimi i rregullave te sigurimit teknik e minimizon kete impakt. Personeli i cili do te punoje gjate zbatimit te projektit do te jete i kualifikuar dhe i trajnuar si per sigurimin teknik ashtu edhe per rreziqet e mundeshme. Ndikimet ne shendetin human gjate shfrytezimit do te jene pozitive pasi do te permiresohen kushtet e infrastruktures dhe zhvillimit.

Ndikimi ne turizem

Pas ndertimit ndikimi ne turizem shoqerohet me permiresimin e infrastruktures dhe sherbimeve te zones.

Ndikimi ne ekonomi

Projekti do te krijoj mundesine e punesimit te banoreve duke ndikuar direkt ne rritjen ekonomike te tyre dhe indirekt ne rritjen e ekonomise se bashkive ku kalon projekti. Ndikimi i ketij aktiviteti ne rang lokal do te jete pozitive dhe me impakt te rendesishem per komunitetin e zones perreth. Gjithashtu ndikimi i ketij aktiviteti do jete dhe rajonal, duke u punesuar specialist te fushave perkatese.

3. Përshkrimi për shkarkimet e mundshme në mjedis

Gjatë fazës së ndertimit dhe funksionimit te *LinjEs e Transmetimit 400 kV Shqiperi - Maqedoni e Veriut (Fier - Elbasan - Qafe Thane)* projekti do të kemi ndikime të cilat do të konsistojë në:

- Emetimet në ajër
- Emetimet e zhurmave
- Gjenerimi i ujërave të ndotur
- Gjenerimi i mbetjeve

3.1 Tabela permbledhese e ndikimeve negative dhe pozitive ne mjedis.

Tabela – Lloji i ndikimeve ne toke

Lloji i ndikimit në tokë	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë fazës së ndertimit		Gjate shkrytezimit	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Humbje e tokave dhe kullotave		X		X
Ndryshimi relievit të tokës	X			X
Humbje e tokes per kullote		X		X
Prishja e tokes bujqesore		X		X
Ndotja e tokes nga rrjedhje		X		X
Ndotja e tokes nga mbetjet e ngurta	X			X
Ndotja e tokes nga depozitimet e Llumrave.		X		X

Ndikimi ne toke

Gjate fazes se ndertimit Nga studimi gjeologjik eshte konstatuar qe zona perbehet nga formacione te qendrueshme: Ndikimi i punimeve per ndertimin e objektit dhe permasat e nderhyrjeve do te jene konsiderueshme, por megjithate keto inerte qe do te dalin gjate punimeve do te sistemohen dhe do te dergohen ne venddepozitimin e miratuar nga Pushteti Vendor. Mund te kete derdhje aksidentale te karburanteve te automjeteve gjate ndertimit te objektit, por me ndikim te perkohshem.

Tabela – Lloji i ndikimeve ne florë, faunë dhe gjeologji

Konsultim me publikun
Linja e Transmetimit 400 kV Shqiperi - Maqedoni e Veriut (Fier - Elbasan - Qafe Thane)

Lloji i ndikimit në florën, faunën	Identifikimi I ndikimit			
	Gjatë fazës së ndertimit		Gjate shkrytezimit	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Shkatërrimi i rendesishemi habitave natyrore		X		X
Rrezikimi i nderhyrjes ne bimet e ujit		X		X
Ndertimi i rrugeve te reja qe kalojne permes zones se virgjër		X		X
Percarje apo izolim te habitave te egra.		X		X

Ndikimi ne perberjen e flores dhe faunes

Nga zbatimi i projektit ndikimet ne flore dhe faune do te jene minimale. Gjate kryerjes se punimeve per ndertimin e linjes elektrike do kete prerje degesh te pemeve qe pengojne shtrirjen e kabujve elektrik dhe do te kete ndikim ne bimesi ne pjesen ku do te ndertohen shtyllat e linjes elektrike. Te gjitha ndikimet ne bimesi do te zbuten nga masat e marra per rehabilitimin dhe sistemimin e mjedisit. Demtimet ne flore dhe faune do te jene minimale ne krahasim me perfitimet qe do sjell zbatimi I projektit.

Tabela – Lloji i ndikimeve në cilësinë e ajrit

Lloji i ndikimit në ajër	Identifikimi I ndikimit			
	Gjatë fazës së ndertimit		Gjate shkrytezimit	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Prodhimi i pluhurit	X			X
Ndojtja nga hidrokarburet, plumbi dhe aerosolet.		X		X
Ndotja nga monoksidi karbonit dhe dioksidit te sqfurit (CO, SO2).		X		X

Ndikime ne Ajer

Gjate fazes se ndertimit te objektit, procesi i punes do perfshije dhe germimet te cilat mund te sjellin emetim pluhurash ne atmosfere. Shoqeria investitore do te zbatoje masat e percaktuara ne raportin e VNM-se ne menyre qe emetimi i pluhurit ne atmosfere te jete sa me i vogel. Ky ndikim do te shfaqet vetem gjate fazes se ndertimit te objektit, gjate ndertimit te shtyllave. Gazet e demshme te cliruara nga djegia e karburantit te automjeteve mund te krijohen gjate fazes se ndertimit te objektit por gjithnje pa i kaluar limitet e lejuara, nderkohe qe gjate shfrytezimit te objektit emetimet e gazeve te demshme do te jene vete nga qarkullimi i automjeteve.

Lloji i ndikimit nga trafiku	Identifikimi I ndikimit			
	Gjatë fazës së ndertimit		Gjate shkrytezimit	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Shtime te rendesishme te qarkullimit te automjeteve.	X			X

Konsultim me publikun
Linja e Transmetimit 400 kV Shqiperi - Maqedoni e Veriut (Fier - Elbasan - Qafe Thane)

Pakesime te vendqendrimeve te automjeteve apo nevoja per vendqendrimete reja.		X		X
Ndikime te rendesishme ne sistemin e komunikacionit.		X	X	
Ndryshime ne qarkullimin apo te levizjes se njerezve dhe mallrave		X	X	

Tabela– Lloji i ndikimeve nga zhurmat

Lloji i ndikimit nga zhurma	Identifikimi I ndikimit			
	Gjatë fazës së ndertimit		Gjate shkrytezimit	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Rritja e nivelit ekzistues të zhurmave	X			X
Rritja e nivelit të zhurmave si rezultat i levizjes së makinave dhe aktivitetit	X			X
Nivel më të lartë të zhurmave për njerëzit	X			X
Nivel më të lartë të zhurmave për kafshët	X			X

Gjate fazes se ndertimit zhurmat dhe vibrimet jane nje ndikim i pashmangshem ne mjedisin ku do te kryhet nderhyrja. Zhurma mund te vijne nga perdorimi i makinerive ne ambientin e punes. Ne rastin tone zhurmat do te jene si pasoje e mjeteve te renda, gjate fazes se ndertimit, gjate germimit, transportit (ngarkim shkarkim). Keto zhurma do te jene te perkohshme dhe nuk do te kete akumulim te saj tek njeriu. Punonjesit do te jene me te prekshmit nga keto zhurma, per te cilet do te kerkohet zbatimi i masave te sigurimit teknik ne pune.

Tabela– Lloji i ndikimeve ndotja e ujrave

Lloji i ndikimit nga ndotja e ujrave	Identifikimi I ndikimit			
	Gjatë fazës së ndertimit		Gjate shkrytezimit	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Trajtimi i ujrave te ndotur.		X		X
Ndotja e ujit prej pluhurit, plumbit, derdhjeve aksidentale dhe substancave te tjera		X		X
Impakti sekondar ne ndotjen e ujit per tokat bujqesore, ujrat nentokesore etj		X		X

Konsultim me publikun
Linja e Transmetimit 400 kV Shqiperi - Maqedoni e Veriut (Fier - Elbasan - Qafe Thane)

Modifikim ne drenazhimin e ujrave natyrale..		X		X
Ndotja e ujrave siperfaqesore dhe nentokesore nga llumrat		X		X

Projekti ne studim ka nje perfshirje te gjere ku perfshin disa lloje ujrash nentokesore dhe siperfaqesor. Ndikimet negative ne ujrat nentokesore mund të vijne nga derdhjet e naftës dhe të ujërave të zeza të krijuara gjatë punimeve të ndërtimit. Gjate fazes se shfrytezimit nuk do te kete ndikime ne ujrat siperfaqesore dhe nentokesore. Investitori do te realizoje monitorim te vazhdueshem te cilesise se ujrave duke kryer analiza ne laboratore te akredituar.

Tabela – Lloji i ndikimeve nga trashëgimia kulturore

Lloji i ndikimit nga Trashëgimia Kulturore	Identifikimi I ndikimit			
	Gjatë fazës së ndertimit		Gjate shkrytezimit	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Ndryshime apo dëmtim të zonave arkeologjike apo me vlera historike e kulturore.		x		x

Në zonat ku kalon Linja e Transmetimit 400 kV Shqiperi - Maqedoni e Veriut (Fier - Elbasan - Qafe Thane) dhe ku do të bëhen punimet riparuese dhe mirëmbajtëse është patur parasysh që në fazën ndërtimore që kjo linjë të jetë larg zonave arkeologjike e me vlera historike apo monumentale që ka zona. Zonat arkeologjike ndodhen në distanca të konsiderueshme nga vendburimet e administruar prej Albpetrol sh.a. Si rrjedhojë në fazën nuk ndikon negativisht vlerat monumentale apo arkeologjike të rajonit.

3.1 NDIKIMET POZITIVE NË MJEDISIN E ZONËS SË PROJEKTIT.

Nga prioritetet e ndikimeve ne mjedis te prezantuara me siper ne menyre te permbledhur jane paraqitur efektet pozitive te zbatimi t te projektit te rehabilitimit dhe ndertimit te objektit.

-Ne fazen e ndertimit te linjes elektrike do te kete hapje te vendeve te reja te punes

-Ndertimi i linjes do te permiresoje kushtet e jeteses se banoreve te zones, nepermjet punesimit gjate ndertimit dhe shfrytezimit.

-Ngritja e kantjerit te ndertimit do te shoqerohet me hapjen dhe zhvillimi e aktiviteve sociale dhe ndihmes dhe efekti kryesor pozitiv do te jete transmetimi i energjise elektrike

-Pritet te kete nje permiresim te sistemit te sherbimeve dhe potencialeve rekreative te zones

-Furnizim pa nderprerje me energji elektrike

-Aktiviteti i ndertimit nuk do t' i shkaktoje ndotje tokes , pasi nuk kete shkark ime ne mjedis .-Nuk do te kemi ndotje te ajrit , sepse gjate punimeve ndertuese do te merren masat perkatese zbutese, ndersa pas perfundimit te ndertimit te linjes elektrike zona do te kthehet ne gjendjen normale.

-Zona do te mbetet me po ato funksion per te cilat eshte destinuar.Rruajtja e zhvillimi i biodiversitetit,sekuestrimi i karbonit sipas marrveshjes se Kiotos ne kuadrin europian (nga ruajtja e tokes dhe mbjellja i bimesise natyrore e te kultivuar). Ekonomike. Perfitimet shkojne me larg se sa vete komuniteti (punesimi i banoreve vendase), Social Kulturore. Sigurimi i nevojave te komunitetit,punesimi etj.

4. Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis

Ky projekt nuk ka dhe nuk do të ketë ndikime negative në shtrirje hapësinore, madje dhe në zonën ku do të zhvillohet projekti këto ndikime do të jenë të pa konsiderueshme dhe vetëm gjatë fazës së ndertimit.

5. Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis

5.1. Programi i menaxhimit

Çdo veprimtari e rëndësishme që kryhet në marrëdhënie me mjedisin, duhet të parashikojë në projektin e saj edhe Planin e Menaxhimit të Mjedisit (PMM), qëllimi i të cilit është parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit të veprimtarisë që propozohet të kryhet.

Qëllimi kryesor i PMM është të sigurojë një proces të drejtë gjatë projektimit, ndërtimit dhe operimit në terma të impaktit dhe masave parandaluese.

5.2. Masat Zbutëse për ndikimet negative

Projekti ka nevojë për monitorim mjedisor rigoroz nga organet kompetente mbikqyrese në kuadrin e mbajtjes nën kontroll të parametrave mjedisor si dhe të veprave të vecanta inxhinierike. Pas ndertimit të veprave duhet të mbahet nën mbikqyrje rehabilitimi i zonave të prekura nga punimet. Monitorimi i ndikimit në mjedis duhet të kryhet nga inspektore të specializuar për mbrojtjen e mjedisit, të kontrollit të ujërave, shërbimit pyjor, pushtetit vendor dhe qendror, MTM – ja dhe ARM – ja. Plani i rehabilitimit ka si qëllim që nëpërmjet realizimit të tij të arrihet mbrojtja e tokës nëpërmjet veshjes pyjore të saj, si dhe përmirësimit mjedisor të territorit. Gjatë aktivitetit për realizimin e projektit do të ketë krijim përgjesh të materialit të ngurtë të germuar por jo të demshme.

Ne baze të ligjit nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, I ndryshuar si dhe ligjit 32/2013, datë 14.02.2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10 463, datë 22.9.2011 Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” shprehim që, gjatë ndertimit të objektit të projektimit, mbetjet gjatë ndertimit të objektit do të dergohet në venddepozitimin e miratuar Pushteti Vendor.

5.3 Mbjellja e sipërfaqeve të reja me fidane . Plani i rehabilitimit

Procesi për sistemimin ku do të krijohen hapësira e terreneve të prekura nga investimi dhe rrafshimin e territorit me gjelberim, nëpërmjet mbjelljes së pemëve apo barit do të fillojë gjatë dhe mbas fillimit të shfrytëzimit. Ky proces do të bëhet mbas një periudhe e cila rezulton me krijimin e kushteve të përshtatshme për mbjelljen e fidaneve. Të gjitha operacionet e më sipërme do të bëhen në përputhje me teknikat e duhura dhe afatet kohore të përshtatshme për të siguruar suksesin e çdo operacioni sidomos mbjelljet që realizohen vetëm në kushte të veçanta klimatike pedologjike. Po kështu kujdesi i vazhdueshëm do të konsiderohet si shtylla e planit të rehabilitimit deri në fazën sa të realizohen sukseset e para biologjike dhe të arrihet klimaksi dinamik i bimesisë dhe zhvillimi i proceseve natyrore në objekt.

I marre në teresi plani i rehabilitimit ka në kontekst ndermarrjen e veprimeve konkrete në sistemimin dhe mbjelljen e sipërfaqeve të lira me bimesi, në funksion të mbrojtjes tokës, përmirësimit mjedisor, në plotësimin e kërkesave të komunitetit si dhe të përmirësimit të kushteve jetësore të tyre. Në këto zone të prekura nga projekti do të mbillen fidane nëse do të ketë prerje të tyre,. Ndikimet në sipërfaqen e tokës për ndertimin e objektit do të jenë vetëm për ndertimin e

bazamenteve te shtyllave. Kjo siperfaqe do te sistemohet dhe rehabilitohet. Siperfaqja rreth kampatave te shtyllave do te mbillet me bar, ndersa pjesa tjeter do te mbillet me bime endemike, Jane perzgjethur keto 2 lloje pemesh pasi gjatesia e tyre nuk ndiko ne linjen elektrike, nuk jane peme qe ecin shume te larta. Gjithashtu klima ne kete zone e favorizon rritjen e tyre. Siperfaqja qe do te rehabilitohet eshte e gjithe siperfaqja e prekur nga gjurma e projektit

Punimet ne pyllzime do te konsistojne kryesisht :

- Skema e mbjelljes do te jete 3x2.2m.
 - Gropat do te hapen ne permasat e meposhteme 40x40x40cm.
 - Gjate hapjes se gropes gjysma e pare e dheut te germuar hidhet ne anen e majte te gropes dhe gjysma e dyte e dheut te germuar ne anen e djathte te gropes .
 - Pas perfundimit te hapjes se gropave sipas projektit nga komisioni qe merr punen ne dorezim behet kolaudimi i punimeve te kryera e numerimin e gropave te hapura dhe ne rast se punimet jane kryer konform rregullave jepet OK per mbjelljen e fidaneve.
 - Fidanet qe do te perdoren per mbjellje do te jene si bimesia vendase
- Fidanet duhet te jene te çertifikuar me çertifikate origjine dhe cilesie te leshuar nga subjekte te licensuar per kete qellim.
- Fidanet e shkukur nuk duhet te lihen per asnje moment ne siperfaqe pa u shtratifikuuar per te mos u demtuar nga ngricat apo demtues te ndryshem
 - Puna per mbjelljen e fidaneve per nje grope behet nga dy punetore njeri mban fidanin perpendikular me themalin e gropes dhe punetori tjeter ben mbushjen me dhe te gropes dhe ngjeshjen e dheut te hedhur ne grope
 - Fidani i mbjellur duhet te jete perpendikulat me qendren e gropes
 - Ne fundin e gropes ne momentin e mbjelljes, hidhen 1-2 lopata dherishte nga horizonti i siperm i tokes, pastaj vendoset fidani duke i futur te gjitha rrenjet ne grope, pa i plagosur apo demtuar ato. Me pas bejme mbushjen e gropes me dhe. Ne fund behet nje ngjeshje e lehte dhe mbathje rreth fidanit.
 - Mbjellja e fidaneve nuk duhet te behet ne periudhe me ngrica
 - Dheu i grumbulluar per rreth fidanit te porsa mbjellur duhet te jete ne forme konkave me qellim per te mos mbajtur ujra gjate periudhes se dimrit qe te mos ngrije uji i depozituar
 - Perqindja e zenjes ne keto objekte te jete 80%
 - Mbjellja e fidaneve keshillohet te behet me mire ne periudhen fundi i nentorit dhe gjate muajit dhjetor, pasi te kete pushuar vegjetacioni.

Procedura punes:

- Pergatitje piketash
- Piketim grope ne mal me dy punetore
- Hapje gropash 40x40x40cm
- Transport fidanesh fletor vjec (me toke) ne krahe ne objekte pyllzimi 200-500 m largesi
- Mbjellje fidanesh 40x40x40cm
- Punetore mirembajtes dhe mbikqyres te objektit
- Transport fidane me auto
- Transport fidanesh me kafshe nga rruga ne objekt
- Blerje fidanesh
- Prashitje fidanesh 5 here

5.4 Masat konkrete per mbrojtjen mjedisit

Mbrojtjen e cilesise se ajrit

Me qellim qe shkarkimet ne ajer qe emeton veprimtaria ndertuese te jene vazhdimisht Brenda normave te lejuara, subjektet ndertues, marrin keto masa: te perdoren mbulesa te perkohshme dhe te lagen sipas

nevojës, një deri dy here në ditë për të reduktuar çlirimet e pluhurave; të mirembahet sheshi i ndertimit gjatë kryerjes së aktiviteteve të nivelimit, ndertimit dhe transportit; të gjitha ngarkesat të sigurohen nepermjet rregullimit, lagies ose mjete të tjera për të parandaluar derdhjet, rrjedhjet dhe pluhurat;

5.5 Programi i monitorimit

Në VKM për programin e monitorimit në RSH jepen qartë indikatorët mjedisorë që monitorohen megjithatë këta indikatorë duhet të përshtaten dhe t'i përkasin veprimtarisë. Qëllimi i monitorimit mjedisor për këtë veprimtari është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse operimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm i burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokës, derdhjeve në ujërat pritës të shkarkimeve të lëndëve të rrezikshme dhe ato urbane etj, kryhet sipas disa kriterëve shkencore përsa i përket vërtetimit, mbledhjes dhe analizave të mostrave. Ai synon në mbledhjen e të dhënave për të vërtetuar dhe parashikuar rolin e faktorit njëri dhe natyror në ndryshimet e mjedisit, ku ai është aktiv. Programi i monitorimit do të përdoret për të verifikuar që të gjitha ndikimet e mundshme që do t'i vijnë Linja e Transmetimit 400 kV Shqiperi - Maqedoni e Veriut (Fier - Elbasan - Qafe Thane).

Objektivat kryesorë të monitorimit

Programi i monitorimit do të përdoret për të verifikuar që të gjitha ndikimet e mundshme që do t'i vijnë mjedisit nga ndërtimi dhe operimi i strukturës hotelarisë, janë marrë parasysh. Programi i monitorimit për secilën ndotje potenciale që mund t'i shkaktohet mjedisit është dhënë me poshtë dhe duhet të mbikëqyret nga AKM.

Objektivat kryesorë të monitorimit janë:

- Për të zbuluar ndryshimet dhe për të karakterizuar saktësisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit të burimeve.
- Për të siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) të burimeve dhe shkaqeve të tyre.
- Për të evidentuar cilësinë e mjedisit ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetësor, me synim për të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e tyre.
- Për të vlerësuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve për menaxhimin e burimeve natyrore.

Linja e Transmetimit 400 kV Shqiperi - Maqedoni e Veriut (Fier - Elbasan - Qafe Thane) do të monitorohet (pikat do të përcaktohen nga organet kompetente), si dhe i dërgojnë këto të dhëna në Agjencinë Rajonale të Mjedisit të paktën katër herë në vite (kjo përcaktohet nga leja mjedisore).

Këto të dhëna do të vihen në dispozicion të inspektoreve të mjedisit gjatë inspektimit të tyre ku nga ana e firmave kontraktuese do të ketë gjithmonë bashkëpunim. Realizimi i objektivave dhe treguesve të pritshëm të parashikuar në projekt do të varet nga respektimi i të gjithë treguesve të përcaktuar.

5.6 Regjistri i të dhënave mjedisore

Për të ruajtur të dhënat mjedisore të veprimtarisë të përgatitet dhe mbahet një regjistër i veçantë ku do të hidhen vazhdimisht të dhënat mjedisore.

Rezultatet e monitorimit të ruhen në regjistër të veçantë duke specifikuar përshkrimet bazë të monitorimit fizik apo matjeve:

- Parametrat e monitorimit
- Pikat e monitorimit (koordinatat)
- Data
- Ora

- Koha e monitorimit
- Aparaturat, pajisjet dhe standardi i monitorimit
- Rezultate e monitorimit

6 Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë)

Konventa "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekst ndërkufitar (Konventa ESPOO)" ka për qëllim vlerësimin e ndikimit në mjedis të projekteve që zhvillohen kryesisht në zona ndërkufitare dhe që mendohet që mund të kenë ndikim në mjedisin e vendeve fqinje. Shqipëria është pale në këtë Konventë që prej 4 Tetorit të vitit 1991. Kjo Konvente synon bashkëpunimin midis shteteve për mbrojtjen e mjedisit ndërkufitar nga projektet me ndikim në mjedis nëpërmjet:

- Njoftimit paraprak të shtetit, mjedisi i të cilit mund të ndikohet nga një projekt i caktuar. Njoftimi bëhet nga Shteti, i cili synon të zbatojë projektin në territorin e tij, i cili e fton Shtetin që mund të ndikohet të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis të projektit të propozuar, duke i dhënë kohë të mjaftueshme dhe vënë në dispozicion raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis të projektit të propozuar;
- Duke e njoftuar Shtetin e ndikuar për vendimin përfundimtar për projektin dhe kushtet për mbrojtjen e mjedisit që duhet të respektohen.

Gjithashtu nga Shqipëria janë ratifikuar edhe amendamentet e saj, vendimet II/14 dhe III/17, nëpërmjet Ligjit Nr. 9478, datë 16.02.2006 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në vendimet II/14 dhe III/17, Amendamentet e Konventës së ESPOO-s "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, në kontekst ndërkufitar".

Subjekt i kësaj konvente janë të gjitha projektet e listuar në shtojcën I të kësaj Konvente, ose më saktë në Amendamentin e dytë të kësaj Konvente, ku janë listuar të gjitha projektet që i nënshtrohen kërkesave të kësaj konvente.

Projekti i propozuar nuk bën pjesë në shtojcën 1 të kësaj konvente dhe mbi të gjitha nuk do të ushtrohet në një territor kufitar.

Pergatiti



"Environmental and Sustainable Development Office"